



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE
THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë për parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 08.02.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti Nr. AKK-DPKI-06-3620/22, për zyrtarin e lartë z. Arben Vitia, (ish) Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, për zyrtarin e lartë z. Arben Vitia, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të pyetjeve dhe informacioneve nga raportues të jashtëm (shkresa nr.: DPKI-06-3620/22), ku kërkohet sqarim, nëse, citoj: “[...] një ministër, apo zëvendësministër i cili /cila e ka lënë punën para dy muajve në ministri, a mund të punësohet në një firmë private-industri e njëjtë ajo me punën të cilën e ka kryer deri para pak muajve në ministri. A duhet që të kaloj një vit që zyrtari i lartë të punësohet në firmën private, apo si është e përcaktuar me ligj”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konform mandatit të saj, fillimisht ka bërë verifikimin dhe konfirmimin e informacionit të mësipërm në institucionet përkatëse, përkitazi me funksionet e (ish) zyrtarit të lartë në fjalë, duke kërkuar dhe mbledhur gjithashtu informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për trajtimin e këtij rasti (DPKI-06-01/3906/22).

Më pas, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-06-01/13/23).

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti, është realizuar edhe një takim më zyrtarin e lartë, ku janë diskutuar dhe ballafaquar të gjitha faktet dhe informacionet që Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka në dispozicion. Nga diskutimet në takim, është parë e nevojshme mbledhja e dokumentacionit plotësues të cilin dokumentacion zyrtari i lartë e ka dërguar në Agjenci (DPKI-06-01/168/23).

Pasi ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes gjithë informacionin dhe dokumentacionin në dispozicion përkitazi me këtë rast, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar gjendjen faktike në vijim:

Deri me datë 01.10.2021, z. Arben Vitia ka qenë Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ndërsa me datë 03.05.2022, z. Vitia ka lidhur kontratë pune me orar të plotë me institucionin privat shëndetësor “Olive Medical Group” SH.P.K.

Me datë 08.12.2022, ka ofruar dorëheqje nga ky institucion shëndetësor, për tu (ri)emëruar më pas, më 26.12.2022, Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Në kërkesën për informacion dhe dokumentacion (DPKI-06-01/3906/22), të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, se:

- Cili është roli i Ministrit të Shëndetësisë në raport me Institucionet private të shëndetësisë, konkretisht, a janë detyrat e tij të lidhura drejtpërdrejtë me *mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin* e aktivitetit të këtyre institucioneve private shëndetësore?, dhe
- Kopje të Licencës (licencave, përfshirë përtëritjen e tyre) të lëshuara për veprimtari shëndetësore të institucionit privat ‘*Olive Medical & Laboratory*’ (*Olive Medical Group*), si dhe akte tjera të (ndër)lidhura me institucionin privat në fjalë;

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë njofton si në vijim:

“[...] Sipas nenit 46 të Ligjit nr. 04/L-125, për Shëndetësi është përcaktuar mbikëqyrja e institucioneve shëndetësore dhe llojet e mbikëqyrjes.

Paragrafi 1 i këtij neni përcakton që, “*Pavarësisht nga mjetet e financimit ose llojet e pronësisë të gjitha institucionet shëndetësore, përfshirë institucionet shëndetësore nga neni 20 i këtij ligji, do të jenë subjekt i mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme*”.

Paragrafi 2 i nenit 46 përcakton që, “*Mbikëqyrja nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të sigurojë zbatimin e dispozitave përkatëse ligjore, normave etike dhe profesionale, si dhe standardeve bashkëkohore në shëndetësi*”. Paragrafi 3 e rregullon “*mbikëqyrjen e brendshme nga paragrafi 1 i këtij neni, përfshinë auditimin e brendshëm dhe organet e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi*”.

Po ashtu paragrafi 4 i nenit 46 përcakton që, “*Mbikëqyrja e jashtme nga paragrafi 1. i këtij neni zbatohet nga Inspektorati shëndetësor, Inspektorati farmaceutik, Inspektorati sanitar, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, dhe organet e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi*”.

Sipas dispozitave në fuqi, “*mbikëqyrjen dhe sanksionimin e institucioneve shëndetësore në Republikën e Kosovës e bën Inspektorati shëndetësor*”.



Ndërsa licencimi i institucioneve private shëndetësore bëhet në bazë të kushteve, procedurave dhe mekanizmave që përcaktohen me ligjin bazik për shëndetësi dhe aktet nënligjore si në vijim:

Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi;

Udhëzim administrativ nr. 08/2014 procedurat për licencimin e institucioneve private shëndetësore;

Udhëzim administrativ nr. 09/2014 kushtet për punë sa i përket hapësirës, kuadrit profesional dhe pajisjeve medicinale të institucioneve private shëndetësore jashtë-spitalore;

Udhëzim administrativ nr. 06/2015 kushtet e përgjithshme dhe të veçanta;

Aplikimi i institucioneve private shëndetësore spitalore dhe jo-spitalore bëhet në bazë të Udhëzimit Administrative 08/2014, përkatësisht në divizionin për licencimin e institucioneve private shëndetësore, ku pas kompletimit të dokumentacionit të nevojshëm lënda përkatëse dërgohet në Komisionet vlerësuese;

Pas vlerësimeve nga komisioni, lënda procedohet në *Bordin për licencim*, i cili pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës *lëshon, refuzon, pezullon dhe revokon licencat* e institucioneve private shëndetësore.

Dosjet e dorëzuara të Institucionit shëndetësor “Olive Medical Group”. [...].

Ndërsa, në kërkesën vijuese për informacion dhe dokumentacion plotësues (DPKI-06-01/168/23), të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, drejtuar z. Arben Vitia, si:

- *Kontratën e punës në Institucionin privat shëndetësor “Olive Medical Group” SH.P.K, si dhe dorëheqjen tuaj më pas nga ky institucion privat shëndetësor;*
- *Informacion/dokumentacion (të mbështetur nga Sekretari i MSH-së), nëse gjatë periudhës sa keni qenë i angazhuar (punësuar) në këtë subjekt privat shëndetësor, jeni përfshirë në marrëdhënie kontraktore me MSH-në;*
- *A është bërë nga ana juaj (në cilësinë e Ministrit të MSH-së), licencimi për kryerjen e testeve RT-PCR për Laboratorin Mjekësor të Mikrobiologjisë Klinike në kuadër të Poliklinikës “Olive Medical Group”;*
- *Informacion/dokumentacion tjetër relevant (nëse ka dhe e vlerësoni të tillë).*

Janë dorëzuar me shkrim përgjigjet vijuese:

“Në cilësinë e zyrtarit kryesor administrativ në Ministrinë e Shëndetësisë siç është kërkuar në shkresën e bashkëlidhur të AKK-së, unë N.B. deklaroj sa i përket pyetjes 2 që gjatë periudhës sa keni qenë i angazhuar (punësuar) në subjektin e cekur privat shëndetësor, nuk keni qenë i përfshirë në marrëdhënie kontraktore me Ministrinë e Shëndetësisë as ju e as subjekti (institucioni privat shëndetësor i cekur)! (përgjigjja e Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë);

Jo. Gjatë kohës kur unë kam qenë Ministër i Shëndetësisë ky institucion nuk ka marrë licencë për kryerjen e testeve RT-PCR për laboratorin mjekësor të mikrobiologjisë klinike në kuadër të Poliklinikës “Olive Medical Group”(përgjigjja e z. Arben Vitia);

Të bashkangjitura në përgjigje kanë qenë edhe kontrata e punës dhe letra e dorëheqjes nga subjekti privat shëndetësor në fjalë”.

Në këndvështrim të situatës së referuar më sipër lidhur me pretendimet për konflikt të interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka shqyrtuar dokumentacionin në dispozicion në frymën e dispozitave relevante të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Me theks të veçantë janë shqyrtuar dhe analizuar dispozitat e nenit 18 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ku janë paraparë *kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike*.

Në këtë mënyrë, me paragrafin 1, nën-paragrafi 1.1, të këtij neni është përcaktuar se:

“1. Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë:

1.1. të punësohet ose të emërohet, për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve vartëse të tyre të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre”.

Ndërsa, nën-paragrafi 1.2, i të njëjtit nen, përcakton se:

“1.2. të përfshihet në marrëdhënie kontraktore, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik”

Nga shqyrtimi dhe analizimi i kontratës së punës së z. Arben Vitia me subjektin privat shëndetësor në fjalë, përkatësisht *Përshkrimin të Detyrave të Punës*, kjo pozitë nuk rezulton të jetë *pozitë udhëheqëse apo menaxhuese*, në kuptim të dispozitës së sipërcituar (neni 18, *para. 1, 1.1*), por pozitë e *profesionistit shëndetësor*, përkatësisht *koordinatorit përgjegjës për cilësi*, prandaj, rrjedhimisht nuk bie ndesh me këtë dispozitë.

Gjithashtu, nga dokumentacioni në dispozicion dhe përgjigjet e deponuara më sipër, nuk përmbushet as kushti i dytë kumulativ i dispozitës në fjalë (neni 18, *para. 1, 1.2*), *sepse* rezulton që, nuk ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë e Ministrisë, në kuptim të *mbikëqyrjes, kontrollit apo sanksionimit të drejtpërdrejtë të aktiviteteve të këtyre institucioneve*, ngase këtë detyrë e kryejnë Inspektorati shëndetësor, Inspektorati farmaceutik, Inspektorati sanitar, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Bordi për Licencim dhe organet e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Veç tjerash, gjatë kohës kur z. Arben Vitia ka qenë Ministër i Shëndetësisë ky institucion nuk ka marrë licencë për kryerjen e testeve RT-PCR për laboratorin mjekësor të mikrobiologjisë klinike në kuadër të Poliklinikës “Olive Medical Group”.


Ndërsa, duke marrë për bazë dhe të mirëqenë përgjigjen me shkrim të Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së, se *‘gjatë periudhës sa z. Arben Vitia ka qenë i angazhuar (punësuar) në subjektin e cekur privat shëndetësor, nuk ka qenë i përfshirë në marrëdhënie kontraktore me Ministrinë e Shëndetësisë, e as institucioni privat shëndetësor në fjalë’*, rezulton se kjo situatë nuk bie ndesh as me dispozitën e sipërcituar, të nenit 18, paragrafin 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Megjithatë, duke pasur parasysh (ri) emërimin e z. Arben Vitia, Ministër të Shëndetësisë, i njëjti duhet të këtë parasysh nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe të tërhiqet nga vendimmarrja, përkatësisht nga çdo veprim zyrtar në ushtrimin e funksionit publik në raport me ish punëdhënësin e tij - institucion privat shëndetësor “Olive Medical Group”.

Nga sa u tha më lartë, kufizimet e zyrtarit të lartë publik pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike sipas nenit 18, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nuk mund të zbatohen në rastin konkret, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit

